



Co-funded by
the European Union



**Not Neat
to be NEET**

“VLERËSIM I PJESËMARRJES NË PROJEKTE RINORE, PENGESAT, NEVOJAT DHE MUNDËSITË E TË RINJVE NË SHQIPËRI”



Autor:

Redona Dudushi

Publikuar nga:

Center for Bridging Communities

© Center for Bridging Communities

Mars, 2025

Tiranë, Shqipëri

Ky projekt zbatohet nga konsorciumi i përbërë nga organizata rinore nga rajoni i Ballkanit Perëndimor: People's Parliament, Serbi; Local Democracy Agency Mostar, Bosnje Hercegovinë; Glas, Mali i Zi; Center for Bridging Communities, Shqipëri dhe Youth Center Drenas, Kosovë në kuadër të programit Erasmus Plus.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	4
Summary	6
Përmbledhje	8
1. Metodologjia	10
1.1 Instrumentat kërkimore.....	10
1.2 Hartëzimi i organizatave rinore në Shqipëri	10
2. Analiza e të dhënave dhe gjetjet	14
2.1 Pyetësi me të rinjtë	14
2.1.1 Të dhënat demografike të të rinjve pjesëmarrës në programe rinore.	14
2.1.2 Informacion mbi pjesëmarrjen në aktivitete rinore	16
2.1.3 Barrierat që raportojnë të rinjtë që kanë marrë pjesë në këto programe kombëtare/ndërkombëtare	18
2.1.4 Avantazhet nga pjesëmarrja në aktivitete rinore	18
2.1.5 Të dhëna mbi të rinjtë që nuk kanë marrë pjesë në programe rinore.....	19
2.2 Fokus grup me punonjës rinore	20
2.2.1 Barrierat për pjesëmarrjen e të rinjve.....	20
2.2.2 Strategjitë për tejkalimin e barrierave rinore	21
2.2.3 Përfshirja e të rinjve në hartim projekt	22
2.2.4 Ndërtimi i kapaciteteve	22
2.3 Fokus grup me të rinj dhe të rinj me më pak mundësi	22
2.3.1 Motivimi dhe përfshirja e të rinjve.....	23
2.3.2 Barrierat që ndikojnë në pjesëmarrjen e të rinjve në programet rinore	24
3. Rekomandime.....	26

Hyrje

Programet e Bashkimit European duhet të ofrojnë mundësi që janë të aksesueshme për të gjithë. Megjithatë këto mundësi nuk janë njësoj të arritshme për të gjithë të rinjtë, për shkak të pengesave që ata mund të hasin në marrjen e shërbimeve. Përfshirja e të rinjve që kanë më pak mundësi në arsim, trajnim dhe punë është objektiv kryesor i disa nismave të politikave të BE-së, si dhe objektiv i këtij projekti që titullohet: “Not Neat to be NEET¹”, ndërtimi i kapaciteteve të organizatave rinore të Ballkanit Perëndimor për projekte më gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrje të të rinjve me më pak mundësi”.

Sipas të dhënave të studimit të Regional Cooperation Council² mbi punësimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor nga viti 2020, përqindja e të rinjve që nuk janë as në punësim as në arsimim ose trajnim (NEET) në Shqipëri krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, është si më poshtë: Norma NEET në Shqipëri në grupmoshat 15-29 vjeç, në vitin 2020 ishte 27.9% e cila është në nivelin më të lartë, krahasuar me Malin e Zi 26.6%, Maqedoninë e Veriut 26.2% dhe Serbinë 20%.

Të kuptuarit e perspektivës së të rinjve me më pak mundësi dhe punonjësve rinorë është një komponent i rëndësishëm për të ndërmarrë veprime efektive. Organizatat rinore duhet të fokusohen në hartimin dhe zbatimin e projekteve rinore më gjithëpërfshirëse që kërkon ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve.

Ky studim synoi të mbledhë të dhëna cilësore dhe sasiore për pozitën dhe statusin e punonjësve rinorë dhe të rinjve në pesë vende të Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kosovë dhe Serbi. Të dhënat e mbledhura nga hulumtimi do të ndihmojnë në ofrimin e rekomandimeve për hartimin e ndërhyrjeve për zhvillimin e edukimit joformal dhe do të krijohet një databazë e të dhënave për zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve në kuadër të projektit.

Edukimi joformal është një komponent i rëndësishëm për të fuqizuar të rinjtë me aftësi dhe kompetenca për jetën. Aktualisht, të rinjve për tu punësuar u kërkojnë një nivel njohurish dhe kompetencash të ndryshme, duke përfshirë aftësitë e buta,

1 NEET - është një akronim në gjuhën angleze, e cila u referohet të rinjve që nuk janë as të punësuar dhe as nuk janë në sistemin e arsimit apo trajnimit.

2 [file:///C:/Users/user/Downloads/Study-on-Youth-Employment-in-the%20Western-Balkans-08072021%20\(2\).pdf](file:///C:/Users/user/Downloads/Study-on-Youth-Employment-in-the%20Western-Balkans-08072021%20(2).pdf)

si: komunikimi, zgjidhja e problemeve, lidhshipi, puna në grup, bashkëpunimi, menaxhimi etj. Këto aftësi nuk mund të përvetësohen në mënyrë efikase në sektorin e edukimit. Ato mund të fitohen përmes aktiviteteve jashtë shkollore në mjedise të të mësuarit joformal.

Sipas Alan Roger, 2003, edukimi joformal plotëson arsimin formal duke adresuar nevojat ose aspektet specifike, që u mungojnë institucioneve të rregulluara, duke e bërë atë një plotësues thelbësor të arsimit tradicional. Në këtë kontekst, Ballkani Perëndimor duhet të zgjerojë mundësitë e të mësuarit për të rinjtë, veçanërisht për të rinjtë me më pak mundësi, në përvetësimin e aftësive përmes aktiviteteve edukative joformale.



Summary

The research “Assessment of participation in youth projects, barriers, needs and opportunities of young people in Albania” was conducted by Center for Bridging Communities as part of the project “*Not Neat to be NEET*” – Building Capacities of the Western Balkans Youth Organizations for More Inclusive Projects and Full Participation of Youth with Fewer Opportunities, funded by the Erasmus+ Program.

This study aims to gain deeper and broader insight from youth with fewer opportunities and youth workers who are part of community-based organizations of youth that design projects and implement services for youth with fewer opportunities. This research, based on a mixed-method approach collected qualitative and quantitative data on the position and status of youth workers and young people in Albania. Methodological instruments used in the study included a survey with 99 responders, one focus group with 10 youth workers, and one focus group with 8 young people.

The participants, from their perspective, describe a range of barriers that make it challenging for youth in general to participate in activities. The barriers reported are **cultural barriers** (language, gender stereotypes, individual and social beliefs, and perceptions about the benefits of activities); **information barriers** (lack of information or excessive and repetitive information reduces interest and motivation to participate); **social and economic barriers** (school doesn't permit participation during school hours, uninformed parents consider it a waste of time, or youth must work); and **time barriers**.

From the survey of a total of 99 young people aged 15-30 years, it turned out that the unemployment rate of the young people surveyed is 51%. The duration of unemployment for those young people who report being unemployed ranges from 6 months, who occupy (53%), to 5 years, and women occupy (84%) of unemployed youth, and (58%) of them reside in towns or villages. The majority of young people surveyed (73%) have attended formal or non-formal education activities during their lifetime.

Most participants report that economic issues directly or indirectly impact the youth's participation in activities. They are compelled to work and miss time to participate in activities, or low economic income prevents them from attending language courses that would enable them to participate in international activities. Some participants mention that youth cannot afford to pay in advance for their participation and must wait until reimbursement.

The majority of participants emphasize specific barriers that affect youth in far-flung areas, such as *transportation barriers* (long walking distance, long waiting time, unavailability of information at the station, and unsafe conditions for walking alone). Also, *self-stigma* is considered a barrier and a cultural barrier (a lack of privacy makes it difficult for people with disabilities and mental health problems to be engaged).

Most of them highlight *language and cultural literacy as the primary cultural and social barriers* that prevent minorities from participating in activities. Most respondents don't see discriminatory behaviors in activities, but they believe stereotypes can make youth feel unequal and decrease motivation in participation.

There is a variation in the perception of the understanding of "youth inclusion," such as increasing the number of young people participating in activities, boosting motivation and commitment to active participation, encouraging participation in a wide spectrum of areas, and ensuring equal inclusion without distinction.

The majority of youth were involved in youth activities, and their involvement ranged from two months to five years. Most of them were involved in national programs. The way of involvement in national and international programs was different. Most of them report that involvement in national programs comes after a period of being a volunteer with a local organization, and then they keep up a stable relationship with the organization. In international activities youth in the focus group report difficulties in obtaining a visa. A few of them would like to implement the knowledge gained from international programs in their communities in rural areas, but they do not have the financial support.

The youth participants *recommendations* to make youth programs more accessible and welcoming are the establishment of a youth platform that would disseminate every activity; the provision of sustainable activities; the improvement of the training providers skills; the offering of grants that youth can use to implement their ideas; and the creation of youth clubs in every city. A few of them consider participation in youth programs as a gate to new perspectives and knowledge that mature them.

All of the youth workers during the focus group agreed that it is important to change the policy regarding the voluntary labor of youth and that volunteering ought to be registered and acknowledged in the contribution plan. The youth worker role should be empowering in the future. They state that improving the inclusivity in youth programs is important. Different viewpoints on how to reach it are increasing the budget; offering a sustainable fund that will secure sustainability in services; improving the legal framework; providing continuous staff training; and increasing cooperation between NGO-s and local institutions.

Përmbledhje

Përfshirja dhe diversiteti janë fusha prioritare të programit Erasmus+ 2021-2027. Pjesëmarrja e të rinjve me më pak mundësi në projektet rinore si: të rinjtë me aftësi të kufizuara, me probleme shëndetësore, që jetojnë në zona rurale dhe të largëta, që përballen me vështirësi socio-ekonomike është sfiduese në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Fakti është se përfshirja e të rinjve me mundësi të pakta shpesh kërkon shumë më tepër përpjekje dhe burime që nuk janë gjithmonë të disponueshme. Si e përballojnë organizatat nga komunitetet më të vogla në rajonin e Ballkanit Perëndimor sfidën e përfshirjes së të rinjve me më pak mundësi në projektet dhe aktivitetet e tyre rinore? Pavarësisht nga kapacitetet e organizatave rinore është shumë e rëndësishme për të gjitha organizatat se çfarë metodologjie përdorin në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve *Erasmus+* që përfshijnë të rinj me më pak mundësi.

Nga anketimi i gjithsej 99 të rinjve të moshës 15-30 vjeç rezultoi se niveli i papunësisë të të rinjve të pyetur është (51%). Kohëzgjatja e papunësisë për ata të rinj që raportojnë se janë të papunësuar varion nga 6 muaj, të cilët zënë (53%), deri në 5 vite dhe femrat zënë (84%) të të rinjve të papunë dhe (58%) e tyre banojnë në qytezë apo fshat. Shumica e të rinjve të pyetur (73%) kanë ndjekur edukim formal ose joformal gjatë jetës së tyre. Aktualisht nuk po ndjekin asnjë formë edukimi formal ose jo formal (14%) e të rinjve, shumicën e të cilëve (57%) e zënë femrat, [>23] vjeç që nuk jetojnë në qytete.

Barrierat e raportuara nga të rinjtë pjesëmarrës në aktivitete rinore janë të larmishme. Në aktivitete kombëtare gjuha e folur kur është anglisht është barriera kryesore, ndërsa në aktivitete ndërkombëtare barrierat kryesore janë ekonomike dhe vështirësitë në marrjen e vizës. Njohja e barrierave në lidhje me programin është e rëndësishme për të rekomanduar ofrimin e ndërhyrjeve specifike në varësi të programit rinor ku të rinjtë janë pjesëmarrës.

Nga fokus grupi me punonjësit rinorë u evidentuan një sërë barrierash që e bëjnë të vështirë pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete. Barrierat e raportuara janë kulturore (gjuha, stereotipet gjinore, stigma, besimet individuale dhe sociale dhe perceptimet për përfitimet nga aktivitetet); pengesat e lidhura me informacionin (mungesa e informacionit); barrierat sociale dhe ekonomike. Shumica e pjesëmarrësve theksojnë

barrierat specifike që prekin të rinjtë në zonat e largëta si mungesa e infrastrukturës rrugore dhe problematikat e transportit. Shumica e organizatave rinore dhe për të rinjtë hartojnë projekte gjithëpërfshirëse duke zhvilluar sesione diskutimi dhe angazhuar të rinjtë që në fillim të hartimit të projekt idesë, duke rishikuar strategjitë rinore.

Nga fokus grupi me të rinj dhe me të rinj me mundësi të pakta, barrierat kryesore janë ekonomike. Gjithashtu mentaliteti i komunitetit mbi rolin e programeve rinore por dhe motivimi i ulët personal i të rinjve në komunitetet ku jetojnë, i lidhur me mungesën e synimeve janë pengesa për pjesëmarrje aktive në projektet dhe programet rinore. Të gjithë të rinjtë që kishin marë pjesë në iniciativa rinore i shohin ato si aktivitete të dobishme. Pjesëmarrësit të cilët u shprehën se në ditët e sotme të rinjtë janë të motivuar për të punuar e lidhin me dëshirën e tyre për të qenë të pavarur dhe për të ndihmuar familjet.

Organizatrat rinore në rajonin e Ballkanit Perëndimor kanë nevojë për ngritjen e kapaciteteve dhe përfshirjen e vullnetarëve dhe stafit të ri, që të punojnë për të mbështetur pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen e të rinjve me më pak mundësi. Gjithashtu punonjësit rinorë aktualë dhe të ardhshëm kanë nevojë për mundësi ndërkombëtare për të mësuar dhe për të punuar me njëri-tjetrin dhe për të krijuar mundësi për përfshirje dhe diversitet më të madh në projektet rinore në rajon.

1.

Metodologjia e studimit

1.1 Instrumentat kërkimore

Ky studim analizoi pjesëmarrjen e të rinjve në edukimin joformal dhe programet rinore në Shqipëri. Instrumentat që u përdorën në kërkim përfshinë fokus grupet dhe pyetësonin online me popullatën e përgjithshme të të rinjve në Shqipëri, të rinjtë me më pak mundësi dhe punonjësit rinorë që janë të angazhuar në organizatat rinore për t'ju përgjigjur pyetjeve kërkimore si në vijim:

- a) Cilat janë pengesat e hasura nga të rinjtë kryesisht nga ata me më pak mundësi në aksesin e shërbimeve rinore të ofruara nga organizatat që punojnë me të rinjtë?
- b) Cilat janë mundësitë që kanë të rinjtë kryesisht ata me më pak mundësi të aksesojnë shërbimet rinore të ofruara nga organizatat që punojnë me të rinjtë?
- c) Cilat janë pengesat që hasin organizatat jo fitimprurëse që punojnë me të rinjtë për të identifikuar dhe për të përfshirë të rinjtë me më pak mundësi?
- d) Cilat janë mundësitë që kanë organizatat jo fitimprurëse që punojnë me të rinjtë për të identifikuar dhe për të përfshirë të rinjtë me më pak mundësi?

1.2 Hartëzimi i organizatave rinore në Shqipëri

Shqipëria konsiderohet një vend i vogël me një sipërfaqe prej 28.748 kilometra katrorë, e cila bën pjesë në Evropën Jugore, në Ballkanin Perëndimor. Sipas “Censurit të Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2023”³, raporti gjinor është 98.2 meshkuj për çdo 100 femra. Struktura e popullsisë është: [0-14 vjeç] 15.6%; [15-64 vjeç] 64,7%; dhe [65+ vjeç] 20%. Ka një rënie të popullsisë në secilën nga dy grupmoshat e para.

³ <https://www.instat.gov.al/en/statistical-literacy/the-population-of-albania/>

Shqipëria është e ndarë në tre zona: veriore, qendrore dhe jugore. Çdo zonë është e ndarë në rajone, dhe çdo rajon është i ndarë në njësi administrative. Në zonën veriore janë të vendosura pesë rajone dhe përmbajnë tetëmbëdhjetë njësi administrative, të cilat zënë 26% të popullsisë së raportuar brenda vendit. Në zonën qendrore ndodhen dy rajone, të ndara në dymbëdhjetë bashki dhe zënë 42% të popullsisë brenda vendit. Referuar Censusit të vitit 2023, afërsisht një e treta e popullsisë shqiptare 31.6% jeton në Bashkinë e Tiranës. Në zonën jugore ndodhen pesë rajone, të cilat përmbajnë tridhjetë e një njësi administrative të cilat përfshijnë 32% të popullsisë së raportuar brenda vendit. Sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale, (NUTS), në lidhje me numrin e banorëve, të gjitha komunat klasifikohen si NUTS 3, e cila ka midis [150,000-800,000] banorë që jetojnë në këto njësi.

Nr		Qarqet	Bashkitë	Numri i Popullsisë	NUT	
Veriore	ZONA	1	Dibër	Diber; Bulqizë; Mat; Klos	106,380	NUT 3
		2	Durrës	Durrës; Shijak; Krujë	289,797	NUT 3
		3	Kukës	Kukës; Has; Tropojë	71,498	NUT 3
		4	Lezhë	Lezhë;Kurbin;Mirditë	114,181	NUT 3
		5	Shkodër	Shkoder; Malesi e madhe; Pukë; Vau i Dejës; Fushë Arrëz	189,164	NUT 3
Qëndrore	ZONA	6	Tiranë	Tiranë; Kamëz, Vorë; Kavajë; Rogozhinë	925,268	NUT 3
		7	Elbasan	Elbasan; Belsh; Cërrik; Gramsh; Librazhd; Prenjas; Peqin	252,719	NUT 3
Jugore	ZONA	8	Berat	Berat; Dimal; Skapar; Polican; Kuçovë	111,431	NUT 3
		9	Fier	Fier; Patos; Roskovec; Lushnjë Divjakë; Mallakastër	271,672	NUT 3
		10	Gjirokastër	Gjirokastër; Libohovë; Dropull; Tepelenë; Memaliaj; Përmet; Këlcyrë	53,314	NUT 3
		11	Korcë	Korcë; Maliq; Pustec; Devoll; Kolonjë; Pogradec	192,925	NUT 3
		12	Vlorë	Vlorë; Selenicë; Himarë; Sarandë; Finiq; Delvinë; Kondispol	183,436	NUT 3

Ky vlerësim i shpejtë, do të synojë të vlerësojë pengesat dhe mundësitë e të rinjve dhe të rinjve me më pak mundësi dhe punonjësve rinorë të angazhuar në organizatat bazë, duke patur një mostër përfaqësuese. Për zgjedhjen e një kampioni sa më përfaqësues në nivel kombëtar u përzgjedhën organizata nga të tre zonat e vendit. Në total u përzgjedhën 6 (gjashtë) organizata rinore dhe me bazë komuniteti që punojnë në hartimin e projekteve dhe shërbimeve me të rinjtë, veçanërisht me të rinjtë me më pak mundësi. Gjithsej 5 (pesë) organizata kombëtare me bazë në komunitet do të përfshihen në fazat e tjera të projektit (si job shadow).

Përzgjedhja e numrit të organizatave në secilën zonë do të llogaritet në raport me përqindjen e banorëve të raportuar që jetojnë atje. Në zonën qendrore të Shqipërisë jeton 42% e popullsisë, pra 42% e 6 organizatave kombëtare të bazuara në komunitet do të jenë afërsisht 2.52. Në zonën qendrore do të zgjidhen 3 organizata kombëtare të bazuara në komunitet.

Në zonën jugore të Shqipërisë jetojnë 32% e popullsisë, pra 32% e 6 organizatave kombëtare të bazuara në komunitet do të jenë afërsisht 1.92. Në zonën jugore, do të zgjidhen 2 organizata kombëtare të bazuara në komunitet. Si rrjedhojë, në zonën veriore të vendit, do të zgjidhet 1 organizatë e bazuar në komunitet (shiko figurën I).




Figura I: Procedura e hartëzimit të organizatave rinore në Shqipëri

Përzgjedhja e organizatave rinore dhe organizatave të bazuara në komunitet do të bëhet nga Center for Bridging Communities, e cila është anëtare e konsorciumit të projektit “Not Neat to be NEET”. Organizata do të përdorë kampionimin e qëllimshëm për përzgjedhjen e organizatave. Kriteret e përdorura për të filtruar organizatat e të rinjve dhe të bazuara në komunitet janë puna me të rinjtë në hartimin e projekteve dhe ofrimi i shërbimeve. Çdo organizatë e përzgjedhur, në bashkëpunim me Center for Bridging Communities do të përzgjedhë dy të rinj, nga të cilët të paktën njëri prej tyre duhet t’i përkasë një grupi të rinjsh me më pak mundësi. Do të mbahet parasysh në përzgjedhje se 30% e të rinjve duhet t’u përkasin të rinjve me më pak mundësi. Gjithashtu, do të përzgjidhet të paktën një punonjës rinor nga secila organizatë për fokus grupet.

2.


Analiza e të dhënave dhe gjetjet

2.1 Pyetësi me të rinjtë

Në kuadër të projektit “Not Neat to be NEET” u shpërnda një instrument vlerësues adresuar të rinjve ndërmjet moshës (15-30) vjeç që jetojnë në fshat, qytezë dhe qytete. Instrumenti vlerësues i përdorur është “pyetësor” dhe u hartua nga grupi i punës, që u angazhua me hartimin e metodologjisë së kërkimit. Pyetësi i strukturuar, me pyetje të mbyllura u përdor për të kryer një vlerësim të shpejtë mbi këndvështrimin në lidhje me sfidat dhe barrierat që ndikojnë në pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete të edukimit joformal si: trajnime, seminare, shkëmbime ndërkombëtare etj. me qëllim ofrimin e rekomandime për ndërhyrje efektive që do të nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në këto programe. Pyetësi përbëhet nga katër sesione kryesore që janë: të dhënat demografike; aksesin në informacion mbi njoftimet për programe rinore; informacion mbi pjesëmarrjen në aktivitete rinore dhe të dhëna mbi të rinjtë që nuk kanë marrë pjesë në aktivitete rinore. Instrumenti vlerësues i përdorur u disimilua online tek të rinjtë me ndihmën e organizatave që ofrojnë shërbime në komunitet.


2.1.1. Të dhënat demografike të të rinjve pjesëmarrës në programe rinore

Pyetësit iu përgjigjën 99 të rinj të grupmoshës [15-30] vjeç, të shpërndarë sipas këtyre grupmoshave: (38.4%) në grupmoshën [15-18] vjeç; (37.4%) në grupmoshën [19-22] vjeç; dhe përkatësisht nga (12.1%) në grupmoshën [23-26] vjeç e [27-30] vjeç. Sipas gjinisë, femrat zënë (78%) të rinjve pjesëmarrës të përgjigjur, ku përqindjen më të lartë e zënë femrat e grupmoshës [15-18] vjeç. Bazuar në etni, (90%) e të rinjve pjesëmarrës të përgjigjur i përkasin etnisë shqiptare, dhe (10%) etnisë romë dhe egjiptianë, prej të cilëve (70%) janë femra ndërmjet grupmoshës [15-18] dhe [19-22] vjeç.




Sipas statusit civil (17%) e të rinjve janë në një marrëdhënie si: martesa; bashkëjetesa dhe fejesa, prej të cilëve (70%) janë femra të grupmoshës [27-30] vjeç. Sipas vendbanimit (48%) e të rinjve jetojnë në fshat dhe qytezë, prej të cilëve (78%) janë femra, dhe prej tyre (60%) janë të grupmoshës [15-18] vjeç.

Të dhënat demografike tregojnë që nuk jetojnë me familjen e tyre (20%) e të rinjve, prej të cilëve (89%) janë femra ndërmjet grupmoshës [19-22] dhe [23-26] vjeç, që vazhdojnë arsimin e lartë në nivelin Bachelor. Të ardhurat ekonomike mujore të familjeve të të rinjve të pyetur variojnë: shumica e të rinjve (21%) raportojnë që jetojnë në familje me të ardhura mujore [\$500-699]. Të ardhura familjare mujore nën rrogën minimale raportohen nga të rinjtë meshkuj që jetojnë në qyteza, ndërsa të ardhura familjare mujore (<\$1100) raportohen nga të rinjtë meshkuj që jetojnë në qytete.



Shumica e të rinjve të pyetur (73%) kanë ndjekur edukim formal ose jo formal gjatë jetës së tyre. Aktualisht nuk po ndjekin asnjë formë edukimi formal ose jo formal (14%) e të rinjve, shumicën e të cilëve (57%) e zënë femrat, [>23] vjeç që nuk jetojnë në qytete. Të jetuarit jashtë qyteteve e bën më të vështirë aksesin në institucionet e edukimit dhe marrjen e informacionin mbi larmishmërinë e formave të edukimit jo formal.




Aktualisht niveli i punësimit të të rinjve të pyetur është (49%), prej të cilëve (56%) punojnë full-time dhe (44%) punojnë part-time. Kohëzgjatja e papunësisë për ata të rinj që raportojnë se janë të papunësuar varion nga 6 muaj, të cilët zënë (53%), deri në 5 vite. Femrat zënë (84%) të të rinjve të papunësuar dhe (58%) e tyre banojnë në qytezë apo fshat. Vihet re se nuk ka ndryshime në kohëzgjatjen e papunësisë sipas vendbanimit.

2.1.2 Informacion mbi pjesëmarrjen në aktivitete rinore

Aksesin në informacion mbi programet rinore e kanë (69%) e të rinjve të pyetur përmes këtij pyetëso. Të rinjtë që nuk kanë akses në informacion mbi programet rinore sipas gjinisë; grupmoshës dhe vendndodhjes janë: (81%) femra; të grupmoshës [19-22] vjeç dhe që jetojnë në qytete në (58%) të tyre.

Prej vitit 2021, (71%) e të rinjve kanë marrë pjesë në aktivitete rinore prej të cilëve në aktivitete ndërkombëtare kanë marrë pjesë (11%) e të rinjve të pyetur. Përkatësisht (33.3%) e femrave që kanë marrë pjesë në këto aktivitete jetojnë në fshat, qytezë dhe

qytet, duke treguar që vendbanimi nuk është barrierë për pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare. Numrin më të madh të pjesëmarrësve në këto aktivitete kombëtare e zënë të rinjtë që jetojnë në qytete të mëdha (52%) dhe shumica e tyre janë femra (64%). Shumica e të rinjve në këto aktivitete i përkasin grupmoshës [19-22] vjeç.




Nga të rinjtë e pyetur që kanë marrë pjesë në aktivitete, pavarësisht llojit të aktivitetit, (82%) raportojnë të kenë marrë pjesë [1-3] herë në aktivitete rinore. Më e shpeshtë është pjesëmarrja e femrave të grupmoshës [19-22] vjeç, që jetojnë në qytet dhe janë duke ndjekur universitetin. Nuk vihen re ndryshime në frekuencën e pjesëmarrjes mes të rinjve të punësuar dhe jo të punësuar. Në të rinjtë e punësuar ata që punojnë part-time kanë marrë pjesë më shumë në aktivitete rinore se të rinjtë të cilët punojnë me kohë të plotë.

Informacioni për të ndjekur aktivitete kombëtare/ndërkombëtare është marrë nga të rinjtë me anë të burimeve të ndryshme, ku vihet re që burimi i informacionit në rrugë informale “shokët, miqtë, e familjarët” zë (64.3%). Dhënia e informacionit nga organizata që operojnë në komunitet është e ulët (14.3%), duke treguar që një barrierë për mos angazhimin e të rinjve në këto aktivitete është dhe mungesa e informacionit të shpërndarë. Përgjithësisht organizatat arrijnë të shpërndajnë informacion tek të të rinjtë deri në 22 vjeç. Nuk ka dallime në shpërndarjen e informacionit në lidhje me komunitetin ku organizatat jo fitimprurëse operojnë. Vihet re që (18%) e të rinjve që janë njoftuar në aktivitetet e mëparshme kanë aplikuar sërish e cila tregon për motivimin e tyre të ulët.

2.1.3 Barrierat që raportojnë të rinjtë që kanë marrë pjesë në programe kombëtare/ndërkombëtare

Barrierat janë vështirësitë që parandalojnë të rinjtë që janë pjesëmarrës në programe rinore të jenë plotësisht të përfshirë në to. Barrierat e raportuara nga të rinjtë pjesëmarrës në aktivitete rinore janë të larmishme. Gjuha e folur në të cilën mbahet aktiviteti rinor raportohet nga (46%) e të rinjve duke e bërë atë barrierën kryesore në shpërndarjen sipas gjinisë, grupmoshës dhe vendndodhjes së të rinjve.



Barrierat e raportuara nga të rinjtë pjesëmarrës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare ndryshojnë nga njëri-tjetri. Në aktivitete kombëtare gjuha e folur kur është anglisht është barriera kryesore, ndërsa në aktivitete ndërkombëtare barrierat kryesore janë ekonomike dhe vështirësitë në marrjen e vizës. Njohja e barrierave në lidhje me programin është e rëndësishme për të rekomanduar ofrimin e ndërhyrjeve specifike në varësi të programit rinor ku të rinjtë janë pjesëmarrës.

2.1.4 Avantazhet nga pjesëmarrja në aktivitete rinore

Perceptimi formon realitetin individual, ndaj mënyra e të perceptuarit dhe e të vlerësuarit të aktiviteteve rinore ka ndikim të rëndësishëm në brendësimin dhe integrimin e njohurive dhe shprehive, motivimit për të vazhduar ndjekjen në ecuri të këtyre aktiviteteve dhe rekomandimin e tyre tek të tjerët. Gjithsej (64%) e të rinjve që morën pjesë në aktivitete kombëtare ose ndërkombëtare raportuan se pjesëmarrja në këto aktivitete i kishte ndihmuar ata të zhvillonin aftësitë e tyre; ndërsa (25%) e të rinjve ishin të pasigurt nëse pjesëmarrja e tyre kishte qenë e dobishme. Sipas gjinisë; grupmoshës; vendndodhjes dhe nivelit të edukimit që po ndjekin aktualisht vihet re që

ka një diferencë në feedbackun për vlerësimin e aktiviteteve rinore. Ato janë vlerësuar më të dobishme në zhvillimin e aftësive nga vajzat; të rinjtë e grupmoshës [27-30] vjeç; të rinjtë që jetojnë në fshat dhe ata që janë aktualisht duke ndjekur universitetin. Sipas gjinisë diferencat në perceptim ndikohen nga rolet sociale dhe përjetimet e ndryshme emocionale. Gjithashtu të jetuarit në zona rurale ku aksesit në aktivitete është i kufizuar ndikon në një vlerësim më pozitiv ndaj aktiviteteve. Por edhe maturimi moshor, i cili shoqërohet me zhvillim konjitiv, emocional dhe rritje eksperience ndikon në perceptimin dhe vlerësimin më pozitiv të pjesëmarrjes në këto aktivitete. Gjithsej 36% e të rinjve që u shprehen pozitivisht ose që ishin të pavendosur për zhvillimin e aftësive të tyre nga pjesëmarrja në aktivitete rinore fokusin kryesor në zhvillimin e aftësive të tyre e vendosnin në “zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik”. Ekziston një ndryshim i dukshëm në vendosjen e fokusit në aftësitë e përvetësuara midis grupmoshave: grupmoshat [15-18] dhe [19-22] vjeç kanë prioritet “zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik”; grupmosha [23-26] vjeç “zhvillimin personal dhe profesional”; dhe grupmosha [27-30] vjeç i dha përparësi “ndërgjegjësimit dhe përfshirjes kulturore”. Një larmishmëri alternativash mbështetje raportohet nga të rinjtë, në (46%) të tyre nevoja kryesore lidhet me arsye ekonomike si “financim shtesë për të kapërcyer problemet me lëvizshmërinë fizike” dhe “bileta të parapaguara”.

2.1.5. Të dhëna mbi të rinjtë që nuk kanë marrë pjesë në programe rinore

Nga të rinjtë që nuk kanë marrë pjesë në aktivitete rinore, (69%) e tyre raportojnë se kanë aplikuar për të marrë pjesë në aktivitete kombëtare ose ndërkombëtare, që nga viti 2021. Sipas grupmoshës, gjinisë dhe vendndodhjes vihet re që (79%) e të rinjve që kanë aplikuar janë të grupmoshës [15-18] dhe [19-22] vjeç; të gjinisë femërore; që jetojnë në qyteza të vogla. Kjo tregon një nivel të lartë të interesimit e motivimit për pjesëmarrje në aktivitete rinore. Motivi kryesor që ka shtyrë të rinjtë për të aplikuar për të qenë pjesë në aktivitete është “rritja e njohurive” të tyre. Arsyeja e “rritjes së njohurive” është nxitësi kryesor për ta pavarësisht moshës, gjinisë dhe vendndodhjes. Identifikimi i nevojave, siç është “rritja e njohurive”, është i rëndësishëm për të njohur sfidat dhe vështirësitë që përballen të rinjtë me qëllim që ndërhyrjet e rekomanduara të përmbushin kërkesat e tyre.

Barriera kryesore në (43%) të të rinjtë që nuk kanë marrë pjesë në aktivitete dhe nuk kanë aplikuar për të marrë pjesë në to që nga viti 2021 është “mungesa e kohës”, ndërsa barrierat nuk ndryshojnë në lidhje me grupmoshën, gjininë dhe vendndodhjen.

2.2 Fokus grup me punonjës rinorë

Në fokus grup morën pjesë 10 pjesëmarrës që përfaqësonin organizata rinore dhe organizata komunitare që punojnë me të rinjtë. Këto organizata dhe institucione ndodhen në Veri (Bashkia Has), Qendër (Tiranë, Librazhd) dhe Jug (Fier dhe Përmet). Moshë mesatare e pjesëmarrësve ishte njëzet e nëntë vjeç dhe varionte nga njëzet deri në tridhjetë e pesë vjeç. Eksperienca mesatare e punës me të rinjtë varionte nga dy vite në dhjetë vjet.

Në fokus-grupin e realizuar, të gjithë pjesëmarrësit mbulojnë funksionin e punonjës rinor, përveç pozicioneve të tjera në organizatë për të cilën janë punësuar. Tre prej pjesëmarrësve janë të përfshirë në hartimin e projekteve rinore.

Shumica e tyre punojnë në disa projekte njëkohësisht, megjithatë, ata i japin përparësi iniciativave të Programit të Korpusit Evropian të Solidaritetit dhe Erasmus+. Gjithashtu një nga pjesëmarrësit po punon në një projekt që integron të rinjtë me nevoja të veçanta në shkollë dhe shoqëri, ndërsa një tjetër punon me të rinjtë egjiptianë dhe romë në rajone të segreguara.

2.2.1 Barrierat dhe sfidat për pjesëmarrjen e të rinjve

Nga këndvështrimi i tyre pjesëmarrësit përshkruajnë një sërë barrierash që e bëjnë të vështirë për të rinjtë në përgjithësi pjesëmarrjen në aktivitete. Barrierat e raportuara janë kulturore (gjuha, stereotipet gjinore, besimet individuale dhe sociale dhe perceptimet për përfitimet e aktiviteteve); barrierat e lidhura me informacionin (mungesa e informacionit ose informacioni i tepërt dhe i përsëritur redukton interesin dhe motivimin për të marrë pjesë); barrierat sociale dhe ekonomike (shkollë nuk e lejon pjesëmarrjen gjatë orarit të mësimi, prindërit e painformuar e konsiderojnë humbje kohe dhe se të rinjtë duhet të punojnë); dhe barrierat kohore.

Shumica e pjesëmarrësve theksojnë barrierat specifike që prekin të rinjtë në zonat e largëta si transporti (distanca e gjatë në këmbë, koha e gjatë e pritjes, mungesa e informacionit në stacion dhe pasiguria për të ecur vetëm). Gjithashtu, vetëstigma konsiderohet si një pengesë kulturore (mungesa e privatësisë e bën të vështirë angazhimin e personave me aftësi të kufizuara dhe me probleme të shëndetit mendor).

Pjesëmarrësit raportojnë se çështjet ekonomike ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete. Ata janë të detyruar të punojnë dhe nuk mund të humbin kohë për të marrë pjesë në aktivitete, ose të ardhurat e ulëta ekonomike i pengojnë ata të ndjekin kurse gjuhësore që do t'i mundësonin pjesëmarrjen në

aktivitete ndërkombëtare. Disa pjesëmarrës përmendën se të rinjtë nuk kanë mundësi të paguajnë paraprakisht për pjesëmarrjen e tyre dhe të presin deri në rimbursimin e shpenzimeve.

Përfaqësuesit nga dy Këshillat Vendorë Rinore, Bashkia Has dhe Bashkia Përmet e vunë theksin në koordinimin e aktiviteteve rinore ndërmjet organizatave. Gjatë fokus-grupit u evidentua se të gjithë pjesëmarrësit kanë përvojë pune me të rinjtë me më pak mundësi. Shumica e tyre shprehen se sfidat specifike të të rinjve me më pak mundësi janë: a) *Infrastruktura e dobët dhe mungesa e transportit publik (të jetuarit në zona rurale, mungesa e transportit, kostoja e lartë e transportit dhe orët e kufizuara të tij); b) Izolimi gjeografik (kufizimi i aksesit në informacion; kufizimi i aksesit në shërbime dhe mungesa e burimeve njerëzore profesionale); c) Burimet e kufizuara financiare dhe mungesa e mundësive për punësim; d) Mentaliteti i shoqërisë dhe familjes (janë më konservatorë dhe skeptikë ndaj këtyre mundësive për të rinjtë që i konsiderojnë jo të qëndrueshme); e) stereotipe të forta për rolet gjinore (vajzat duhet të martohen herët; nuk duhet të jenë më të arsimuara se bashkëshorti etj). f) Mungesa e koordinimit ndërmjet organizatave të komunitetit dhe bashkive.*

2.2.2 Strategjitë për tejkalimin e barrierave rinore

Sipas pikëpamjes të punonjësve rinorë shumë të rinj me mundësi të pakta të cilët kanë kapërcyer barrierat si motivimi i ulët janë angazhuar në shkrimin e projekteve dhe koordinimin e aktiviteteve rinore. Për të minimizuar barrierat e transportit janë vendosur mjete për transportin e të rinjve, sigurimin e parave të rimbursimit ose përdorimin e kuponëve të karburantit për familjet.

Strategjitë trajtojnë në mënyrë efektive nevojat e të rinjve dhe në çdo projekt që realizohet ka aktivitete për të rinjtë me pak mundësi. Një punonjës rinor përmendi “një kamp veror në një zonë të largët të Bashkisë Fier ku të rinjtë angazhohen dhe gjithashtu punësojnë të rinj nga ajo zonë”; një tjetër përmendi “një laborator arti të lëvizshëm që udhëton në zona të ndryshme të largëta një herë në muaj për një gjysmë dite”. Disa prej tyre që punojnë me të rinjtë me aftësi të kufizuara përmendin se për të siguruar përfshirjen e këtij target grupi, ata përpiqen të krijojnë një mjedis gjithëpërfshirës duke përdorur mësuesin mbështetës (terapistin), një mësues të gjuhës së shenjave, duke organizuar aktivitete në një vend me rampë për karriget me rrota dhe duke përdorur forma alternative të të mësuarit. Shumica e punonjësve për të rinjtë u shprehën se aktivitetet ndikojnë pozitivisht në jetën e të rinjve dhe zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre.

“Ndihej mirë me veten time dhe kënaqem duke punuar me të rinjtë, sepse ofroj shpresë se gjërat do të përmirësohen dhe njëkohësisht mësoj gjëra të reja prej tyre” -u shpreh një pjesëmarrës.

Të gjithë punonjësit rinorë konfirmuan se bashkëpunojnë në nivele të shumta me organizata të tjera kombëtare dhe institucione qeveritare për të rritur aksesin dhe përfshirjen dhe se bashkitë janë bashkëpunëtorët kryesorë të organizatave.

2.2.3 Përfshirja e të rinjve në hartim projekti

Shumica e organizatave rinore dhe për të rinjtë hartojnë projekte gjithëpërfshirëse duke zhvilluar sesione diskutimi dhe angazhuar të rinjtë që në fillim të hartimit të projekt idesë, duke rishikuar strategjitë rinore. Për të angazhuar të rinjtë të cilët janë më apatikë u përdorën qasje të ndryshme, të tilla si dhënia e përgjegjësisë, krijimi i aktiviteteve të ndryshme, ndërgjegjësimi dhe bërja e aktiviteteve rinore sa më tërheqëse. Disa prej tyre deklarojnë se sfida kryesore për ta bërë projektin më gjithëpërfshirës dhe më të aksesueshëm për të rinjtë është t'i bësh projektet të qëndrueshme, të nxitësh motivimin e tyre dhe të ndihmosh të rinjtë të kuptojnë rëndësinë e këtyre aktiviteteve.

2.2.4 Ndërtimi i kapaciteteve

Të rinjtë dhe të rinjtë me pak mundësi kanë nevojë për aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të fokusuara në metodat e të mësuarit të teknologjisë dhe për mbështetje financiare në lidhje me transportin në rastin kur jetojnë në zona të largëta. Disa pjesëmarrës në fokus grup u shprehën se kufizimet në fonde nuk mundësuan zbatimin e aktiviteteve në zona rurale ose sigurimin e qëndrueshmërisë së këtyre aktiviteteve. Sipas njërit prej punonjësve rinorë, kufizimi i fondeve vështirëson bashkëpunimin mes palëve të interesuara në projekt dhe një pikë tjetër për tu theksuar është se kufizimet financiare nuk kanë mundësuar vlerësimin e nevojave si një fazë paraprake të projektit. Disa prej pjesëmarrësve u shprehën se bashkëpunimi me organizata të tjera është thelbësor për ofrimin e aktiviteteve më cilësore, pasi ato shkëmbejnë ekspertizën, shmangin mbivendosjet dhe ndajnë kostot.

2.3 Fokus grup me të rinj dhe të rinj me më pak mundësi

Gjithsej tetë të rinj morën pjesë në fokus grup, katër prej të cilëve ishin të rinj me më pak mundësi. Shpërndarja gjeografike e pjesëmarrësve ishte në veri (Kukës, Has); në qendër (Tiranë dhe Librazhd); në jug (Fier, Përmet) dhe tre prej tyre jetonin në zona rurale. Mosha mesatare e pjesëmarrësve ishte njëzet e një vjeç, e cila varionte nga gjashtëmbëdhjetë vjeç deri në njëzet e pesë vjeç dhe shumica e pjesëmarrësve ishin femra. Shumica e pjesëmarrësve ishin me arsim të lartë dhe u shprehën se arsimi është një pjesë e rëndësishme e jetës së tyre. Shumica e tyre e shohin arsimin si një proces që zhvillon aftësitë profesionale dhe personale dhe i përgatit ata për tregun e punës.

Disa të rinj e shohin arsimin si një filtër që u mundëson të dallojnë pikat e forta dhe mangësitë e tyre në aftësi. Shumica e tyre e perceptojnë të mësuarit e bazuar në punë si zhvillim të aftësive të buta profesionale me theks në etikën e punës. Një pjesë e madhe e të rinjve kanë përvojë pune dhe tre prej tyre kanë punë sezonale. Aktualisht shumica e pjesëmarrësve në fokus grup janë të papunë. Në grupin e të rinjve që janë të punësuar, kohëzgjatja mesatare e këtij punësimi është nëntë muaj dhe ata punojnë në sektorin e shërbimeve si kamerierë, shitës etj. Të rinjtë e papunë kanë qëndruar të papunë për gati gjashtë muaj mesatarisht. Të gjithë të rinjtë duan të ndjekin një karrierë profesionale në lidhje me formimin e tyre arsimor.

2.3.1 Motivimi dhe përfshirja e të rinjve

Pikëpamjet e pjesëmarrësve për motivimin e të rinjve për të punuar ndahen midis atyre që mendojnë se të rinjtë duan të punojnë dhe atyre që mendojnë se në ditët e sotme të rinjtë janë më pak të motivuar për të punuar. Pjesëmarrësit të cilët u shprehën se në ditët e sotme të rinjtë janë të motivuar për të punuar, e lidhin me dëshirën e tyre për të qenë të pavarur dhe për të ndihmuar familjet. Shumica e të rinjve që u shprehën se të rinjtë në ditët e sotme nuk janë të motivuar për të punuar ia atribuon këtë idesë se të rinjtë duan të fitojnë para shpejt dhe lehtë. Disa prej tyre e lidhin mungesën e motivimit me ofertat për punësim jashtë fushës së tyre, pagat e ulëta dhe pushimet e shpeshta nga puna. Shumica u shprehën se do të punonin për një pagë minimale 40.000 lekë nëse puna do t'i ndihmonte të merrnin aftësi profesionale. Shumica u përgjigjën se është jashtëzakonisht e vështirë për të gjetur punë në profesionin e tyre dhe se të gjitha mundësitë e punës janë për punë të pakualifikuara. Të gjithë pjesëmarrësit u përgjigjën se shumica e të rinjve mbështeten nga familjet e tyre, veçanërisht nga të afërmit që punojnë jashtë vendit.

Ka një variacion në perceptimin e të kuptuarit të *“përfshirjes së të rinjve”*, siç janë: rritja e numrit të të rinjve që marrin pjesë në aktivitete; rritja e motivimit dhe angazhimit për pjesëmarrje aktive; inkurajimi i pjesëmarrjes në një spektër të gjerë fushash dhe sigurimi i përfshirjes së barabartë pa dallim.

Për shkak të sfidave të tilla si jetesë në zonat rurale dhe problemet shëndetësore, katër nga të rinjtë e fokus grupit e shohin veten si *të rinj me më pak mundësi*, pasi kanë më pak akses në informacion, mundësi arsimimi dhe mbështetje dhe si rezultat zotërojnë më pak aftësi.

Shumica e të rinjve ishin të përfshirë në aktivitete rinore dhe përfshirja e tyre varionte nga dy muaj deri në pesë vjet ku mbizotëronin programet kombëtare rinore. Mënyra

e përfshirjes në programet kombëtare dhe ndërkombëtare ishte e ndryshme. Shumica e tyre u shprehën se përfshirja në programet kombëtare vjen pas një periudhe të të qenit vullnetar në një organizatë lokale dhe më pas ata mbajnë një marrëdhënie të qëndrueshme me organizatën, e cila u dërgon e-mail për aktivitete të ndryshme nëse dëshirojnë të përfshihen. Sipas një të riu pjesëmarrës, mësuesit e kanë njoftuar në shkollë. Ata aplikojnë për të marrë pjesë në programe ndërkombëtare, pasi janë informuar për thirrjet nga Këshilli Vendor Rinor (KVR), organizatat jofitimprurëse dhe të afërmit.

Ajo që fillimisht i motivon të rinjtë për të marrë pjesë në programe është e ndryshme nga ajo që i shtyn ata të vazhdojnë të marrin pjesë në këto aktivitete. Pjesëmarrja e të rinjve fillimisht synon ndërveprim social, aftësi sociale dhe miqësi. Arsyeja pse ata të gjithë vazhdojnë të përfshihen është sepse ata kanë përfitime nga zhvillimi i aftësive në këto aktivitete dhe gjithashtu ata duan të përmirësojnë jetën në komunitetet e tyre. Fushat me interes të aktivizmit rinor janë fushatat ndërgjegjësuëse, mentorimi, projektet komunitare në zonat rurale, të drejtat e njeriut, demokracia, teknologjia, të mësuarit përmes artit dhe përfitimi i aftësive të buta.

2.3.2 Barrierat që ndikojnë në pjesëmarrjen e të rinjve në programet rinore

Faktorët që ndikojnë në motivimin për të marrë pjesë në aktivitetet rinore janë të ndryshëm. Të gjithë pjesëmarrësit i konsiderojnë faktorët ekonomikë vendimtarë për pjesëmarrjen e të rinjve, veçanërisht për të rinjtë që jetojnë në zonat rurale. Njëri prej tyre u shpreh: “Nëse organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë do të presin që familjet të mbulojnë shpenzimet e fëmijëve në programet rinore, askush nuk do ta ndjekë aktivitetin”. Të rinjtë mendojnë se në rastet kur duhet të paguajnë për të marrë pjesë në programet rinore shpesh familjet e tyre nuk e përballojnë dot, ndaj e anashkalojnë informacionin”, shtoi një tjetër pjesëmarrës nga një zonë rurale.

Të gjithë të rinjtë që iu përgjigjën kësaj pyetje trajtuan si sfidë edhe mentalitetin e komunitetit mbi programet rinore, emigrimin e të rinjve dhe gjithashtu, disa të rinj konsiderojnë si barrierë motivimin e ulët personal të të rinjve në komunitetet ku jetojnë, të lidhur me mungesën e synimeve.

Pjesëmarrësit, me përjashtim të atyre nga Tirana, u shprehën se programet në qytetet e tyre janë shumë të kufizuara dhe kur ato janë të disponueshme nuk janë aktivitete afatgjata dhe shpesh nuk janë të qëndrueshme. Disa prej të rinjve janë të angazhuar në Këshillat Vendorë Rinorë ndërsa disa të tjerë dëshirojnë të zbatojnë njohuritë e marra nga programet ndërkombëtare në komunitetet e tyre por nuk kanë mbështetje financiare.

Pjesëmarrja e të rinjve **në programe rinore** ka shumë përparësi. Të gjithë të rinjtë që morën pjesë në iniciativa rinore i shohin ato si aktivitete të dobishme. Një pjesëmarrës tha se *“pjesëmarrja në aktivitetet rinore fuqizoi dhe zhvilloi aftësitë dhe kompetencat e mia, të cilat janë vendimtare në jetë”*. Të gjithë theksuan krijimin e rrjeteve dhe zhvillimin e aftësive sociale. Rrjetëzimi ishte i rëndësishëm sepse ndihmoi në zhvillimin profesional të tyre duke u dhënë atyre akses në burime, mundësi dhe udhëzime për karrierë. Zhvillimi i aftësive të tyre sociale është i rëndësishëm sepse siguron mirëqenien e tyre dhe i mëson me etikën e punës. Disa prej të rinjve e konsiderojnë pjesëmarrjen në programet rinore si një portë drejt perspektivave dhe njohurive të reja që i maturojnë ata.

Rekomandime

Programet rinore duhet të jenë më gjithëpërfshirëse. Roli i punonjësit rinor duhet të fuqizohet në të ardhmen dhe është e rëndësishme të ndryshohet si politika por dhe qasja në lidhje me punën vullnetare të të rinjve dhe gjithashtu të rishikohen aspektet ligjore mbi regjistrimin e punës vullnetare dhe në planin e kontributeve. Në Mars 2025 në parlamentin shqiptar u miratuan disa ndryshime në ligjin Nr. 75/2019 “Për Rininë” të cilat i japin rrugë njohjes së rolit të punonjësit rinor duke inkurajuar në këtë mënyrë çdo organizatë rinore dhe organizatë për të rinjtë të rekrutojë një punonjës rinor. Perspektivat për përfshirjen e të rinjve janë të ndryshme si: kuptimi i nevojave dhe përshtatja e aktiviteteve për ta; përfshirja e të rinjve në të gjitha fazat e projektit; krijimi i mundësive të barabarta; tejkalimi i stereotipeve dhe nxitja e marrëdhënieve të qëndrueshme.

Rekomandimet e punonjësve rinorë nga organizatat rinore në fokus grup për arritjen e gjithëpërfshirjes janë: *rritja e buxhetit; ofrimi i një fondi që do të sigurojë qëndrueshmëri në shërbime; përmirësimi i kuadrit ligjor; trajnimi i vazhdueshëm i stafit të organizatave rinore dhe organizatave me bazë komunitare, zhvillimi i mëtejshëm i kompetencave të punonjësve rinorë dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet organizatave joqeveritare dhe institucioneve vendore.*

Pjesëmarrja e të rinjve në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare fillimisht synon ndërveprim social, aftësi sociale dhe miqësi. Arsyeja pse ata të gjithë vazhdojnë të përfshihen është sepse ata kanë përfitime nga zhvillimi i aftësive dhe kompetencave në këto aktivitete dhe gjithashtu ata duan të përmirësojnë jetën në komunitetet e tyre. Fushat me interes të aktivizmit rinor janë fushatat ndërgjegjësuese, mentorimi, projektet komunitare në zonat rurale, të drejtat e njeriut, demokracia, teknologjia, të mësuarit përmes artit dhe përfitimi i aftësive të buta. Të rinjtë janë të vetëdijshëm se të menduarit kritik është komponent i rëndësishëm në vendimet që marrin dhe sjelljet që performojnë duke i ndihmuar në analizën, vlerësimin dhe interpretimin objektiv dhe racional të informacionit që marrin.

Rekomandimet e të rinjve dhe të rinjve me mundësi të pakta për t'i bërë programet rinore më të aksesueshme dhe më mikpritëse janë: *krijimi i një platforme kombëtare burimore mbi aktivitete rinore, ofrimi i aktiviteteve që nxitin inovacionin dhe kanë impakt shoqëror dhe qëndrueshmëri, përmirësimi i aftësive të ofruesve të trajnimeve, ofrimi i granteve që të rinjtë mund t'i përdorin për të zbatuar idetë e tyre rinore në çdo qytet etj.*



Co-funded by
the European Union

"Not Neat to be NEET" non-profit project is funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor the EACEA can be held responsible for them.